



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1772/Prot.
/

Tiranë, më 12.07.2023

VENDIM
Nr. 68, datë 12.07.2023

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË
NË PROGRAMET E STUDIMEVE “SHKENCAT E LËVIZJES”, “FUSHAT E
VEPRIMTARISË FIZIKE, TË SHËNDETIT DHE REKREACIONIT” DHE “SHKENCAT E
REHABILITIMIT”
PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, Nr.10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024”, Rektorati në mbledhjen e datës 12 korrik 2023

VENDOSI:

1. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brënda datës **06 gusht 2023** shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve në programet përkatëse të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe ia përcjell dy njësive kryesore dhe i afishon në mjediset e tyre dhe në faqen zyrtare elektronike.
2. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkurset e pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, janë **12-15 gusht 2023 nga ora 09:00 deri në 15:30**.
(Regjistrimi do të jetë i hapur për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes deri në orën 11.00 të datës 19 gusht 2023 dhe për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit deri në orën 11.00 të datës 22 gusht 2023).
3. Dokumentet që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurset e pranimit do të jenë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje kartës së identitetit
 - Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
 - Kartela mjekësore.
4. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe

Rekreacionit brënda datës **15 gusht 2023** shpall listat e kandidatëve të regjistruar për konkurset e pranimit.

5. Datat e zhvillimit të konkursit të pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes janë **16 – 19 gusht 2023**.
6. Datat e zhvillimit të konkursit të pranimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit janë **20 – 22 gusht 2023**.
7. Rregulloret e konkurseve të pranimit, testet praktike, kartela mjekësore gjënden në faqen zyrtare të UST-së.
8. Fatura e tarifës së konkurimit publikohet në datën **07 gusht 2023** pas miratimit nga Bordi i Administrimit të UST-së.
9. Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brënda **21 gusht 2023** shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit pranë *Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit*.
10. Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brënda datës **24 gusht 2023**, afishon dhe publikon listën e renditjes së aplikantëve të të tre Fakulteteve, duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre të maturës.
11. Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në datë **25 gusht 2023** ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në Portalin U-Albania.
12. Regjistrimi në Raundin e I-rë të kandidatëve fitues në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë në UST do të zhvillohet në datat **29 gusht – 11 shtator 2023** (*7 faza/48-orëshe nga ora 08.00 – 16.30*).
13. Kriteret e pranimit, kuotat e pranimit, testet e konkursit së bashku me rregulloren e përkatëse si dhe plani mësimor për ciklin e parë të studimeve publikohen në faqen zyrtare të UST-së dhe Portalin U-albania.
14. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi dhe marrjen e të gjitha masave për zhvillimin e gjithë procedurave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, Administratori i UST-së, Zv/Rektorët, Dekanatet e Fakulteteve, Drejtorja e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studëntët.
15. Ky vendim shpallet në faqen zyrtare të UST-së.
16. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. AGRON KASA

